



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **30.12.2020** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Bajram Morina.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndes anëtarët e Komitetit për Komunitete, Ky është takimi i pestë dhe i fundit për vitin 2020, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi –Të nderuar para se me qitë rendin e ditës në votim, a keni diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth Procesverbalit të kaluar, atëherë nëse jo e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.

Të nderuar sa i përket Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020, ju materialin e keni para vete, nëse doni unë mundem edhe të ju lexoj këtë raport, nëse jo atëherë fjala është e juaj nëse keni diçka për të shtuar sa i përket këtij raporti.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket punës së komitetit për komunitete për vitin 2020, siç e dini ky vit ka qenë një vit shumë i vështirë për të gjithë, kjo ka qenë edhe njëra nga arsyet pse ne si komitet për komunitete i kemi mbajtur vetëm 5 takime. Shpresoj se viti 2021 do jetë një vit i mbarë dhe ne si komitet për komunitete propozoj që ti i mbajmë 12 takime në vite ashtu siç është përcaktuar edhe në planin e punës.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket takimeve të komitetit për komunitetet për vitin 2020 e tha edhe znj. Mirjeta Krasniqi një arsye se pse ndoshta nuk kemi mundur ti i mbajmë më shumë takime. Poashtu i bashkëngjitëm propozimit të zonjës në fjalë që në vitin 2021 takimet e komitetit për komunitetet të mbahen çdo muaj, pra të jenë 12 takime në vite. Kam informata nga koleg të komunave tjerra të Kosovës që komiteti për komunitetet në komunat e tyre i mbanë rregullisht në çdo muaj takime, prandaj edhe ne duhet që ti mbajmë 12 takime në vitin 2021.

Darko Antiq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Në vitin që jemi duke kenë pas komiteti si komitet ka bërë diçka, ka bërë disa vizita siç është edhe cekur në raporte, por nëse shikojmë se sa janë përgjigjur kërkesave tona nga komuniteti serb që kanë ardhur, mundemi të themi shumë pak. Lagja e epërme e Rahovecit nuk është e banueshme vetëm me komunitetin pakicë aty jeton edhe komuniteti shumicë, prandaj kresat tonë si për ndriçim publik, kanalizim pastaj ajo që disa herë është përsëritur është kontejnerë për mbeturina, shpresoj se në vitin e ardhshëm kjo punë të realizohet.

Kryesuesi – I nderuar po i kuptoj shqetësimet e juaja, por kjo ka ndodhur pakës edhe për shkak të situatës së krijuar me Covid – 19, por shpresoj se në vitin e ardhshëm do të rregullohet e gjitha.

Lendrit Qeli – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Sa i përket asaj që e tha i nderuari z. Darko Antiq munden me them se situata e krijuar pak na ka bërë që mos të mundemi të i kryejmë disa punë, kurse sa i përket ndriçimit publik, ka qenë një keqkuptim me Kedsin, por kjo tani është sqaruar dhe Kedsin një pjesë të ndriçimit e ka rregulluar pritet edhe pjesa tjetër. Kurse sa i përket kontejnerëve dhe kanalizimit ne besojmë se në fillim të vitit 2021 do të zgjidhet ky problem.

Ramë Berisha - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar viti që jemi duke lënë pas ka qenë një vite i vështirë jo vetëm për ne por për të gjithë, prandaj shpresoj se në vitin e ardhshëm duhet të punojmë të gjithë së bashku në mënyrë që të sjellim diçka mirë për komunitetin tonë. Puna e përbashkët dhe ekipore është punë më e mirë dhe nëse bashkëpunojmë si deri më tani besoj se do të kemi suksese.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin zhvilluar, nëse nuk ka askush diçka për të diskutuar sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, kalojmë në pikën e radhës.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021.

Të nderuar plani i punës së Komitetit për Komunitet çdo vite është përkrahur nga OSBE-ja, por për shkak të rrethanave të krijuara këtë vite nga pandemia virusi Covid – 19, nuk kanë mundur të na mbështesin. Ne për vitin 2021 e kemi marrë të njëjtin plan sikurse në vitin 2020 që ka qenë vetëm kemi ndryshuar vitet, prandaj nëse keni diçka për të shtuar fjala është e juaja.

Ali Zhuniqi - Sa i përket Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021, mendoj se si plan është i mirë, por kam një vërejtje tek kolona ku ceket se vizita e e vendbanimeve dhe shkollave ku jetojnë komuniteti jo shumicë, ceket se ka qenë mungesa e interesimit të anëtarëve të komitetit për kryerjen e vizitave. Kjo mendoj se nuk është e vërtetë sepse unë asnjëherë nuk kam qenë i ftuar që të shkojë në vizitë, poashtu edhe viti këtu që ceket 2020 në fund besoj se duhet të jetë 2021.

Kryesuesi – I nderuar po ju sqaroj se nuk ju kam ftuar për arsye të gjendjes me covid – 19, vizitat janë bërë nga ana ime së bashku me zyrën për kthim dhe komunitete. Kurse sa i përket asaj që ceket në plan nuk ka të bëjë me ju që nuk keni qenë prezent por është cekur sepse në kolonën më sipër ceket rreziqet dhe supozimet, kjo ka qenë arsyeja pse është cekur mungesa e interesimit të anëtarëve të komitetit për kryerjen e vizitave. A ka dikush tjetër të shtoj diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit:

4. Të ndryshme.

Ramë Berisha – E kam një shqetësim të cilin e kam paraqitur edhe në mbledhjet e kaluara se i përket një ure, ku kam kërkuar që të vendosen rrethoja mbrojtëse, këto rrethoja kanë qenë por janë hequr dhe janë tek një komshi. Prandaj kishte me qenë mirë që të vendosen sepse nesër mundet të jetë shumë vonë nëse ndodh diçka larg qoftë ndonjë fëmijë të bie, prandaj lusë drejtorin kompetente të ndërmerr masa sa më shpejtë.

Kryesuesi – A ka edhe dikush të shtojë diçka, nëse jo atëherë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë gjatë vitit 2020 si anëtar të Komitetit për Komunitete, shpresoj se edhe vitin 2021 do të kemi bashkëpunim sa më të mirë dhe do të kryhen sa më shumë punë. Edhe një herë gëzuar festat shihemi në takimet e radhës.

Procesmbajtësi

Agim Hoti

